

KONTRATË THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Aquarius Team” Sh.P.K.

Sot me datë 13.05.2021, në Sarandë, me vullnetin tonë të lirë, ne të nënshkruarit:

- Antonio Francesco Seminara, i biri i Salvatore, i datëlindjes 13 Janar 1953, lindur në Catania dhe banues në Via S.Neri (Ct) Itali, mbajtës kartës së identitetit me numër AX6784388, i cili përfaqësohet sipas Prokurës së Posaçme Nr.repertori 407, Nr.koleksioni 209, datë 13.03.2021 nga z.Luan Metani me numer personal G76202111N
- Adri Sina, i biri i Dashnor, i datëlindjes 04 Maj 1986, lindur në Vlorë dhe banues Lagjja “28 Nëntori”, Rruga “Konstandin Kristoforidhi” Vlorë, mbajtës kartës së identitetit me numër personal I60504104S,

ne zbatim të Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare të Regjistrimit” ,

Neni 1

Vendosa të themeloj shoqërine me përgjegjësi të kufizuar **“Aquarius Team” shpk.**

Neni 2

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Veprimtari të argëtimit në ujë, ski uji, ekskursione me kanoe
- Menaxhimi i shërbimeve turistike të ujit (varka, anije)
- Tregëti me shumicë dhe pakicë
- Import-Export
- Ndërtim dhe mirëmbajtja për vete dhe për të tretët e varkave për turizëm, për peshkim, i varkave me vela, varkave me motor, me rema.
- Ndërtimi i moleve për ankorimin e mjeteve ujore
- Agjensi imobiliare

Neni 3

Ortakt themelues të shoqërisë janë: z.Antonio Francesco dhe z. Adri Sina.

Neni 4

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë ose zvogëlojë kapitalin sipas vendimeve të organeve drejtuese të kësaj shoqërie.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën e 75,000 lekë (shtatëdhjetë e pesë mijë) dhe përbëhet nga 2 (dy) kuota, e ndarë si më poshtë:

1. Antonio Francesco, kontribuon me 1 (një) kuotë prej 60.000 (gjashtëmijë) lekë, ose 80%

të kapitalit themeltar

2. Adri Sina, kontribuon me 1 (një) kuotë prej 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) lekë, ose 20% të kapitalit themeltar

Neni 6

Selia e shoqërisë është Lagja 1, Rruga "Skënderbeu", Godinë private, Sarandë.

Neni 7

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar në kohë dhe fillon që nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 8

Administrator i shoqërisë dhe të jetë znj. Marjana Koçi, e cila do të qëndrojë në këtë detyrë për 5 vite, me të drejtë rizgjedhje dhe është i ngarkuar të kryejë akte dhe të marrë angazhime që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 9

Personaliteti juridik i shoqërisë fitohet me regjistrimin e saj në regjistrin tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Aktiviteti i saj do të fillojë pas kryerjes së procedurave ligjore. Në aktivitetin e shoqërisë do të përmbahemi statutit të hartuar për këtë qëllim dhe do të respektoj legjislacionin në fuqi. Kjo kontratë themelimi u redaktua në katër kopje, me vlerë të njejtë ligjore, një kopje dorëzohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, një kopje dorëzohet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë dhe nga një kopje ortakëve themelues të shoqërisë.

ORTAKËT E SHOQËRISË "Aquarius Team" SH.P.K.

LUAN METANI
Antonio Francesco Seminara _____

Andri Sina _____